



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusha



01. Nr. 007-19

Me 28.02.2019

Mamushë

Në pajtim me Nenin 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në zbatim të nenit 36, paragrafi 3, të Rregullores Financiare Nr.01/2013-MF - Shpenzimi i parave publike Rregullore MF - nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Neni 92 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 08/12/2008, Kuvendi i Komunës së Mamushës, miraton këtë:

V E N D I M
PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT
E NDARJES SE SUBVENCIONEVE

Neni 1

Në mbledhjen e mbajtur më datën 28/02/2019 Kuvendi i Komunës së Mamushës, ka votuar me vota unanime për Miratimin e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes se subvencioneve

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunes së Mamushës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dergimit në autoritetin mbikeqyres MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelin e shpalljeve ose Web faqen zyrtare të Komunes

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Zyra e Kryetarit të Komunës
2. Drejtorët e Drejtorive;
3. Ministria e Pushtetit Lokal;
4. Ministria e Ekonomisë dhe Financave si dhe
5. Arkivi.


Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në pajtim me Nenin 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në zbatim të nenit 36, paragrafi 3, të Rregullores Financiare Nr.01/2013-MF - Shpenzimi i parave publike, Rregullore MF - nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Neni 92 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 08/12/2008, Kuvendi i Komunës së Mamushës, me 28.03.2019, miraton këtë:

RREGULLORE PER KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SE SUBVENCIONEVE

Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik.
2. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga organet dhe trupat komunale gjatë ndarjes së subvencioneve për përfituesit

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Subvencionet** - për kuptim të kësaj rregullore subvencionet përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik
 - 1.2 **Pagesa e pakthyeshme** - është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.
 - 1.3 **Përfituesi** - nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore.
 - 1.4 **Banor rezident** - nënkupton personi që jeton dhe vepron në Komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Neni 3 Limitet buxhetore

Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal për të cilën ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë lig).

Neni 4

Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna nëse i ka të përfunduara obligimet ndaj Komunës, përveç përfituesve të rasteve emergjente shëndetësore.
3. Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve tjera të personit fizik dhe juridik mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë Komuna.
4. Kryetari i komunës aprovon ndarjen e subvencioneve në këto limite: Për. personat fizik deri në 1000 euro, për persona juridik deri në 2000 euro.
5. Nëse subvencionimi financiar ka të bëjë me shumë më të madhe se është përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni për të njëjtin vendos kuvendi komunal.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të vecanta në fushën e shëndetësisë dhe ndihmës momentale në bazë të kërkesës së arsyetuar atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera të rëndësishme.
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas procedurave të parapara në nenin 9 të kësaj Rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet 20 ditë pune nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 6

Përjashtimet nga ndarja e subvencioneve

1. Përfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizik jo rezident të Komunës.
2. Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna.
3. Përjashtim nga paragrafi 2 i këtij Neni bëjnë subvencionet e ndara për persona fizik në fushën e shëndetësisë dhe për nevoja ushqimore (mirëqenie sociale).
4. Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në vendimin apo me marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për 3 (tre) vitet e ardhshme përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve.

Neni 7

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisione të përkohshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe konform autorizimeve, që jepen nga Kryetari i Komunës.
3. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mund të jenë shërbyes civil të Komunës.
4. Përbërja e Komisionit duhet të jetë prej 5 anëtarëve, njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë zyrtar i financave dhe një anëtarë duhet të jetë nga shogëria civile që ka fushëveprim të ngjashëm me fushën që do të ndahet subvencioni.
5. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
6. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarje të subvencioneve.

Neni 8

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja

1. Komisioni bënë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve brenda afatit prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit të shpalljes publike.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe legjislacionin në fudi.
3. Rekomandimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e saj tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
5. Komisioni i rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe i rekomandon marrjen e vendimit për ndarje të subvencioneve.
6. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione do të refuzohen nga Kryetari me rekomandim të Komisionit.
7. Komuna i njofton sa më shpejt që është e mundur të gjithë aplikuesit në baza individuale për përfshirjen ose jo në listën e përfituesve të subvencioneve dhe i njofton për të drejtën dhe procedurën e parashtrimt të ankesës.
8. Kryetari mund të kërkojë që Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të bëjë rivlerësimin e kërkesave apo të anulojë gjithë procesin e vlerësimit dhe të caktojë komision të ri për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve.
9. Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve, në përputhje me rekomandimin e Komisionit, në afat prej 5 ditë pune pas përfundimit të afatit të paraqitjes së ankesave të përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve

1. Kryetari i Komunës emëron komisionin me mandat dy vjeçar për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve.

subvencionimit, raportimin, hyrjen në fugi si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen, përveç subvencioneve në fushën e shëndetësisë dhe ndihmës momentale.

Neni 14

Subvencionet për arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. bursa për student;
 - 1.2. bursa për nxënës në shkollë të mesme;
 - 1.3. bursa për nxënës në shkolla fillore;
 - 1.4. kuadrot deficitar;
 - 1.5. nxënësit me nevoja të vecanta;
 - 1.6. gara apo kuize (aktivitete jashtë mësimore);
 - 1.7. botimin e librave/revistave;
 - 1.8. nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - 1.9. mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Kategoritë dhe shumat e subvencionimit do të përcaktohen me vendim të vecantë të Kryetarit të Komunës për çdo vit fiskal.

Neni 15

Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

1. Kryetari i Komunës me vendim të vecantë përcakton kriteret të qarta për dhënien e bursave duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në :
 - 1.1. Notën mesatare;
 - 1.2. Numri i studentëve/nxënësve në familje;
 - 1.3. Kategoritë e dala nga lufta (vetëm për studentë);
 - 1.4. Banimi në zona rurale;
 - 1.5. Rezultatet në gara;
 - 1.6. Gjendja ekonomike.
2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të bursave përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 2.1. Dokumenti i identifikimit;
 - 2.2. Certifikata e notave;
 - 2.3. Certifikata e vitit kalendarik të studimeve;
 - 2.4. Certifikatë e vendbanimit;
 - 2.5. Dëshmia mbi gjendjen ekonomike;
 - 2.6. Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta;
 - 2.7. Dëshmi për rezultatet në gara;
3. Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti gendror ose ndonjë donatorë tjetër për fushën e njëjtë.
4. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave e cila publikohet në ueb fagen e Komunës, në vendet e frekuentuara, mediat sociale dhe në media lokale.

Neni 16

Subvencionet për zhvillim ekonomik

1. Komuna mund të ndajë subvencione për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

- 1.1 Zejet tradicionale;
- 1.2 Aksesore;
- 1.3 Agrobizneset;
- 1.4 Teknologji Informative;
- 1.5 Ndërmarrjet publike;
- 1.6 Biznese inovative;
- 1.7 Ndërmarrje sociale;
- 1.8 Aktivitetet e shogatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmit;
- 1.9 Inkubatorët e biznesit;
- 1.10 "Start-up" bizneset;
- 1.11 Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillim të biznesit;
- 1.12 Aktivitetet për hulumtime të tregut të grupeve të studentëve.
2. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunë.
3. Përfitues të subvencioneve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

Neni 17

Përparësitë gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 1.1. Bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim,
 - 1.2. Grave, të rinjve, zonave rurale, personave me nevojë të vecanta dhe komunitetet;
 - 1.3. Bizneset që kanë siguruar bashkëfinancim nga palë të treta prej 60% të vlerës;
 - 1.4. Bizneset të cilat posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale.
 - 1.5. OJQ-të të cilët aplikojnë me projekte biznesi të cilat mundësojnë gjenerim të vendeve të punës.
 - 1.6. Bizneseve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencionit për zhvillim ekonomik të ndarë nga pushteti gendror ose nga ndonjë donator tjetër.
2. Bizneset e përcaktuara në paragrafin 1.3 dhe 1.4 të këtij neni mund të aplikojnë për ndarje të subvencioneve edhe jashtë periudhës së shpalljes publike me kërkesë të arsyetuar.

Neni 18

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për e subvencione për zhvillim ekonomik

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për zhvillim ekonomik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Plani i biznesit;
 - 1.2. Dokumenti identifikues;
 - 1.3. Certifikate e vendbanimit (për persona fizik);
 - 1.4. Certifikata e biznesit;
 - 1.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 1.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
 - 1.8. Dëshmi për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim);
 - 1.9. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

Neni 19

Subvencionet për bujqësi

1. Komuna mund të ndajë subvencione për bujqësi duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. projekte të fermerëve, shogatave, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për Komunën;
 - 1.2. organizimin e panaireve, seminareve, vizitave studimore;
 - 1.3. mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim;
 - 1.4. projekteve në sektorin e pylltarisë.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:
 - 2.1. Zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna;
 - 2.2. Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim prej 25% të vlerës, me përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe;
 - 2.3. Grave, të rinjve, personave me nevoja të vecanta dhe minoritetet;
 - 2.4. Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për bujqësi të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

Neni 20

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione në bujqësi

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat juridik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
 - 1.2. Certifikata e biznesit;
 - 1.3. Projekti dhe plani financiar;
 - 1.4. Fletë posedim për patundshmëri;
 - 1.5. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 1.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.7. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
 - 1.8. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
 - 1.9. Dokumenti identifikues i personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimit.
 - 1.10. Dëshmi se nuk është përfitues i një subvencioni të ndarë nga pushteti qendror në këtë fushë brenda vitit fiskal.
2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 2.1. Numri identifikues i fermerit (NIF);
 - 2.2. Projekti dhe plani financiar;
 - 2.3. Fletë posedim për patundshmëri;
 - 2.4. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 2.5. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 2.6. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

Neni 21

Subvencionet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

1. Komuna ndanë subvencione për banorët rezident për përballimin e shpenzimeve të shërimit sipas kritereve të përcaktuara nga drejtoria përgjegjëse për shëndetësi.
2. Subvencionet për shëndetësi jepen duke përfshirë por duke mos u kufizuar:
 - 2.1. Rastet e rënda shëndetësore;
 - 2.2. Rastet e sëmundjeve jo të rënda kronike por pa burim të të ardhurave;
 - 2.3. Shpenzimet e varrimit;
 - 2.4. Shpenzimet e lehonis;
 - 2.5. Fushatat e vetëdijesimit për shëndetin publik;
 - 2.6. Mirëqenie sociale,
 - 2.7. Strehimi në Qendrën e Sigurte,
 - 2.8. Strehim familjar.
3. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 3.1. Numri i anëtarëve të familjes;
 - 3.2. Cështja e banimit;
 - 3.3. Kostoja e trajtimit;
 - 3.4. Gjendja ekonomike familjare;
 - 3.5. Trajtimi në institucionet private (nëse një sëmundje e tillë nuk mund të trajtohet në institucionet publike).
4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përshëndetësi nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 4.1. Diagnoza e mjekut specialist;
 - 4.2. Dokumenti i identifikimit;
 - 4.3. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
 - 4.4. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore.
 - 4.5. Personat, për subvencionet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të ndahen edhe pa shpallje publike por me kërkesë të arsyetuar

Neni 22

Subvencionet për kulturë, rini, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Klubet sportive
 - 1.2. Sportistët e dalluar
 - 1.3. Garat sportive
 - 1.4. Shoqëritë amatore (ansamblet)
 - 1.5. Teatrot amatore
 - 1.6. Festivalet
 - 1.7. Botimi i librave
 - 1.8. Ekspozitat me fotografi
 - 1.9. Aktivitete me karaktere garuese
 - 1.10. Pjesëmarrje në festivale jashtë komune
 - 1.11. Promovim i librave
 - 1.12. Promovim i talentëve të rinjë
 - 1.13. Aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS

1.14 KVRL

1.15. Qendra Rinore

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:
 - 2.1 Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
 - 2.2 Projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme;
 - 2.3 Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër
3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë, por duke mos u kufizuar:
 - 3.1 Projekt propozimi;
 - 3.2 Aplikacioni;
 - 3.3 Dokumenti identifikues;
 - 3.4 Certifikate e vendbanimit (për persona fizik);
 - 3.5 Certifikata e regjistrimit (për persona juridik);
 - 3.6 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
 - 3.7 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik);
 - 3.8 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
 - 3.9 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

Neni 23

Raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve

1. Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna, përjashtim në fushën e shëndetësisë, ndihma momentale dhe bursave në arsim, obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ.
2. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu sic janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet të ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve etj.).
3. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ i cili duhet të ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.
4. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë 30 ditë pune pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen në mes palës përfituese dhe komunës apo në vendimin e Kryetarit të Komunës
5. Raportet nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohen dhe një kopje të dorëzohet në arkivin e komunës.

Neni 24

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve.

2. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të vecantë të përfituesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.
3. Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite nga data e përfitimit të subvencionit.

Neni 25

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve brenda 2 ditë pune pas vendimit për ndarje të subvencioneve nga Kryetari.

Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbaj: emrin e përfituesit, rastin, fushën për të cilën jepet subvencioni dhe shuma e ndarë

Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna nuk i publikon subvencionet për rastet e përcaktuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.4, 2.5, 2.6 të nenit 21.

Publikimi i vendimeve dhe i përfituesve nga ndarja e subvencioneve bëhet në ueb-faqen e Komunës, në tabelat e shpalljeve si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e Komunës.

Neni 26

Subvencionimi i OJQ-ve

Për çdo rast subvencionimi të OJQ-ve që bëhet nga Komuna e Mamushes ose në partneritet me Komunen e Mamushes, vlejne rregullat e Rregullores MF - nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve në tersi, duke përfshirë anekset e saj, si formularët etj.

Neni 27

Dispozitat transitorë dhe shfuqizuese

1. Ndarja e subvencioneve e filluar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje vazhdon me rregullativën ekzistuese.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja paraprake.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

01 Nr. 003-19

Mamushë,

28.03.2019

Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusha



01. Nr. 008-19
Me 28.03.2019
Mamushë

01 No.Nr. 008-19
Tarih/Di. 28.03.19

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (e), 17 shkronja (f), 40.2 shkronja (a), Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 neni 8 shkronja (a), neni 15 pika (f), neni 19.1, Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060 neni 15 pika 1.8, Statuti i Komunës së Mamushës neni 6 , Kuvendi i Komunës ne mbledhjen e mbajtur më 28.03..2019 miratoi:

V E N D I M
PËR

PER MENAXHIMIN E MBETURINAVE NE TERRITORIN E KOMUNES SE
MAMUSHËS

Neni 1

Në mbledhjen e mbajtur më datën 28/03/2019 Kuvendi i Komunës së Mamushës, ka votuar me vota unanime për Miratimin e Draft Rregullore per Menaxhimin e Mbeturinave ne territorin e Komunes se Mamushës

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Shërbime Publike – Sektori i Inspeksionit.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit te Komunes se Mamushes, ky vendim hyn ne fuqi 15 dite pas dergimit ne autoritetin mbikeqyres MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike ne tabelin e shpalljeve ose Web faqen zyrtare te Komunes

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Zyra e Kryetarit të Komunës
2. Drejtorët e Drejtorive;
3. Ministria e Pushtetit Lokal si dhe
4. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek






Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (e), 17 shkronja (f), 40.2 shkronja (a), Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 neni 8 shkronja (a), neni 15 pika (f), neni 19.1, Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060 neni 15 pika 1.8, Statuti i Komunës së Mamushes neni 6 , Kuvendi i Komunës ne mbledhjen e mbajtur më 28.03..2019 miratoi:



DRAFT R E G U L L O R E
PER MENAXHIMIN E MBETURINAVE NE TERRITORIN E KOMUNES SE
MAMUSHËS

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me kete rregullore përkohëqet orari, sistemi dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe rieklimit të mbeturinave, llojin, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnereve , mirëmbajtja e vendeve ku grumbullohen ato dhe mënyrën e transportimit.

PERGJEGJESITE DHE DETYRAT E KOMUNES

Neni 2

Përgjegjësitë e Komunës

Përgjegjësitë dhe detyrat e Komunës, të parapara me Ligjin për mbeturina në këtë rregullore, janë:

- Hartimi i planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave;
- Hartimi i raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave;
- Rregullimi i përgjegjësisë dhe detyrave për kryerjen e shërbimeve;
- Informimi i publikut;
- Zbatimi i procedurës së prokurimit për përzgjedhjen e operatorit për mbeturina;
- Caktimi i tarifave dhe mënyra e arketimit të mjeteve financiare;
- Mbikëqyrja e menaxhimit të mbeturinave;
- Dhënia e informatave dhe rekomandimeve dhe
- Lidhja e marrëveshjeve me komunat tjera për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 3

Llojet e mbeturinave

Sipas kësaj rregulloreje, mbeturinat komunale janë:

Mbeturina inerte, qe nuk treten, nuk ndizen dhe nuk kane si pasoje reagime fizike ose kimike, qe nuk kane zberthim biologjik ne kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojne ne menyre te ndjeshme ne mjedisin dhe shendetin e njeriut.

Mbeturina te parrezikshme, qe nuk paraqesin rrezik per mjedisin dhe shendetin e njeriut dhe nuk kane karakteristika te mbeturinave te rrezikshme.

Mbeturina te vellimshme, mbeturina me permasa te medha fizike nga pajisjet dhe makinerite.

Mbeturina nga konstruktim-demoliinet, mbeturina të mbetura nga konstruktimi dhe demolimi i objekteve.

Neni 4

Plani i veprimit

Plani i Veprimit te Komunes duhet te jete ne pajtim me Planin e Republikes se Kosoves per menaxhimin e mbeturinave te nxjerra nga Ministria, me pjesët e pershkruara ne dispozitat e nenit 10 te Ligjit perkatës.

Neni 5

Menaxhimi i mbeturinave

5.1 Të gjitha subjektet, te cilat ne perputhje me natyren e veprimtarise se tyre, krijojne lloje te ndryshme mbeturinash, duhet te bejne ndarjen e tyre.

5.2 Cerdhet dhe shkollat, institucionet e arsimit te larte qe veprimtarine e tyre e ushtrojne ne territorin e komunes, duhet të edukojne nxenesit - studentet ne perputhje me rregullat bashkekohore te trajtimit te mbeturinave.

5.3 Shoqërite qe ofrojne sherbime tregtare, hoteliere dhe sherbime tjera, kane per obligim te mbajne

mjedisin e paster perreth objekteve, perfshire edhe trotuarin para objektit.

5.4 Te gjithë krijuesit e mbeturinave jane te obliguar te regjistrohene ne listat e sherbimit te konsumatoreve për mbledhje dhe bartjen e mbeturinave.

Neni 6

Kontejnerët e mbeturinave

6.1 Komuna percakton llojin, vellimin, numrin, vendin dhe qellimin e vendosjes se kontejnereve te mbeturinave, si dhe periudhen kohore te mbledhjes se tyre.

6.2 Per mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave perdoren kontejnere dhe shporta, si ne vijim: Madheisia e shportave per mbeturina te amviserise, percaktuar ne liter:

- a) 60 l
- b) 80 l
- c) 120 l

Shporta e vellimeve te ndryshme, te vendosura ne trotuare dhe parqe.

6.3 Ne shtepite dhe objektet private duhet pasur se paku dy kontinjere per hedhjen e mbeturinave te ndara.

6.4 Numri i kontenjereve duhet te pershtatet me numrin e banoreve ne objektet e perbashketa te banimit dhe llojin e mbeturinave qe krijojne. Hedhja e mbeturinave shtepiake nga personat e objekteve te banimit kolektiv, behet ne kontenjer apo ne vendet per mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave.

6.5 Ambulanca dhe objektet tjera per sherbime mjeksore, duhet te perdorin sistemin e ndare te kontinjereve, me qellim te ndarjes se mbeturinave mediconale dhe mbeturinave tjera.

6.6 Qytetaret duhet të jenë informuar mbi llojin e kontinjereve të ofruar nga Komuna, në bashkëpunim me operatorët. Njeri kontinjer shërben për hedhjen e mbeturinave organike, ndërsa kontinjeri tjetër shërben për mbeturina tjera të riciklueshme.

Neni 7

- 7.1 Kontinjeret për hedhjen e mbeturinave duhet të vendosen në vende të dukeshme dhe të përshtatshme, ku nuk shkaktojnë pengesë apo rrezik për levizjen e lirë të qytetarëve dhe qarkullimin e mallrave.
- 7.2 Kontinjeret duhet të kenë ngjyrë të ndryshme ose mbishkrime të dukeshme që udhëzojnë për klasifikimin e mbeturinave.
- 7.3 Kontinjeret në masë deri 1.1 m³ duhet të kenë mekanizëm mbylles dhe ata për ndarje kapak mbylles.
- 7.4 Kontinjeret duhet të kenë sipërfaqe të limuar, që mund të pastrohen lehtësisht dhe materiali i tyre (metall, plastikë, etj.) duhet të jetë të qëndrueshëm dhe i papërshkueshëm nga uji.
- 7.5 Kontinjeret për mbeturina duhet të jenë teknikisht të përshtatshëm për automjetet që bëjnë zbrazen të tyre.
- 7.6 Lokacionet për vendosjen e kontinjereve i cakton Komuna, në përputhje me planin rregullues.
- 7.7 Kontinjeret dhe shportat e mbeturinave lejohen në përdorim nga ana e Komunës, në përputhje me kërkesat e operatorit ose edhe paleve të treta të kontraktuara.
- 7.8 Orarin dhe dinamikën e mbledhjes së mbeturinave e përcakton Komuna, në bashkëpunim me operatorin.
- 7.9 Komuna sipas nevojës autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë.
- 7.10 Operatori në bazë të marrëveshjes me Komunën, vendos numrin e nevojshëm të kontinjereve në hapësirat e objekteve të përbashkëta të banimit.
- 7.11 Komuna përcakton llojin e kontinjerit të përshtatshëm me teknikën me të cilën bëhet mbledhja, ndarja dhe transportimi i tyre.

Neni 8

Skema organizative dhe zona e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave

- 8.1 Komuna miraton dhe publikon skemën organizative me strukturë dhe përmasa të shërbimit për mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave për çdo vendbanim, lagje apo hapësirë ose sipërfaqe publike.
- 8.2 Mbledhja dhe ndarja e mbeturinave neper rrugë, sheshë, trotuare dhe hapësira ose vende brenda qytetezës duhet të bëhet në pjesën urbane prej orës 22:00 deri në orën 05:00 të mëngjesit, kurse në periferi edhe gjatë ditës.
- 8.3 Pastërtia brenda qytetezës sigurohet gjatë ditës, duke grumbulluar dhe larguar nga sheshet, rrugët, trotuaret dhe hapësirat tjera.
- 8.4 Mbledhja dhe ndarja e mbeturinave neper rrugë, sheshë, trotuare dhe hapësira ose sipërfaqet tjera në vendbanime rurale ku janë të vendosura kontinjeret me mbeturina, duhet të bëhet brenda 24 orëve sipas orarit të përcaktuar.
- 8.5 Kriteret për përcaktimin e zonave, sipas paragrafit 6 të këtij neni, i cakton Komuna.

Neni 9

Pikat mbledhëse për mbeturinat e vëllimëshme

9.1 Komuna bënë zgjedhjen dhe caktimin e vendeve – pikave grumbulluese të mbeturinave, caktimin e hapësirave për ndertimin e qendërave më të mëdha për grumbullimin e tyre në vendbanimeve periferiketë qytetit apo edhe ato rurale.

9.2 Caktohen pikat grumbulluese të mbeturinave sipas planit rregullues,

9.3 Pika mbledhëse për mbledhjen e mbeturinave duhet të plotësojë këto kushte:

- a. Të ketë sipërfaqe të mjaftueshme për mbledhjen e mbeturinave
- b. Sipërfaqja duhet të jetë e asfaltuar ose betonuar;
- c. Të ketë infrastrukturë tekniko-ndërtimore dhe objekte përcjellëse;
- d. Të ketë zyrën e personelit për pranimin e mbeturinave;
- e. Të ketë peshorën për matje të mbeturinave;
- f. Të ketë kontnjere të mjaftueshme për hedhjen e mbeturinave dhe
- g. Të ketë objekte apo hapësira të tjera të mbuluara për manipulim me

Neni 10

Dorzimi i mbeturinave të kosrtuktim – demolim

- 10.1 Gjate procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve, personat duhet t'i largojë nga hapësirat ose vendet publike mbeturinat që krijohen.
- 10.2 Mbeturinat e krijuara nga ndërtimet, meremetimet apo demolimet e objekteve në masën deri 0.1 m³, mund të hedhen në kontinjer 5m³, të masës 4000 kg për mbeturinë inerte, sipas paragrafit 6 të kësaj rregullore.
- 10.3 Dorëzimi i mbeturinave të krijuara nga ndërtimet, meremetimet apo demolimet e objekteve në masën më 1/10 m³, është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 05/07, për mbeturinat nga konstruksioni dhe demolim.
- 10.4 Transporti i këtyre mbeturinave bëhet nga vet prodhuesi ose në marrëje për në pikat e mbledhjes së mbeturinave ose në vend- deponite të caktuara nga Komuna.

Neni 11

Dorëzimi i mbeturinave brenda territorit të komunes

- 10.1 Të gjithë personat fizik dhe juridik që krijojnë mbeturinë, kanë të drejtë të kenë qasje në shërbimet publike për hedhjen e mbeturinave.
- 10.2 personat duhet të paguajnë për shërbimin e ofruar në bazë të tarifës të miratuar nga Komuna.
- 10.3 Krijuesi i mbeturinave detyrohet që mbeturinat t'i ndajë dhe t'i vendosë sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.
- 10.4 Amvistrin dhe krijuesin tjetër të mbeturinave, obligohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vendet të caktuara për mbledhjen e tyre, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në pikat mbledhëse apo në vendet e caktuara për to.

Neni 12

Ndalesat

Sipas dispozitave të kësaj rregullore ndalohet:

- 10.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike,
- 10.2 Hedhja e mbeturinave të llojeve të tjera në kontinjeret ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk nahejnë ashtu siç është paraparë,

- 10.3 Hedhja e mbeturinave ne hapësirat e perbashketa brenda dhe jashte objeteve të banimit kolektiv (Ballkonet, Korridoret, terracat e banesave etj.),
- 10.4 Perzirja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontinjerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme
- 10.5 Hedhja e mbeturinave ne rruge nga automjetet në lëvizje,
- 10.6 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe, dhe ne vendet tjera publike);
- 10.7 Ndërrimi i vendendodhjes së kontinjerëve, pikave ose vendeve të betonuarapër hedhjen e mbeturinave pa autoizim të autoritetit komunal;
- 10.8 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontinjereve ose në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;
- 10.9 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshet apo të ngajëshme nga kontinjerët ose nga pikat mbledhëse te mbeturinave;
- 10.10 Shfrytëzimi i kontinjerve publike nga bizneset, veprimtarite ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturina komunale dhe komerciale”;
- 10.11 Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontinjerë ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar;
- 10.12 Hedhja e mbeturinave jashtë kontinjerëve të mbeturinave;
- 10.13 Dredhja dhe rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për në deponi të mbeturinavë;
- 10.14 Gjatë transportit të mbeturinave, duhet të ndermerren masa që automjetet e tyre të kënaq mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të të derdhjes, shpërndarjes, apo rrjedhjes deri në destinimin e tyre në impiant për trajtim ose në deponi të mbeturinave;
- 10.15 Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës hde teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e peraktuara me kontratë apo ndonjë formë tjetër;
- 10.16 Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimëshme nuk goxojnë të hedhën në kontinjerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre.
- 10.17 Cdo ndryshim i kushteve nga paragrafi 12.8 i këtij neni, duhet të miratohet me shkrim nga organet kompetente lkomunale, duke marrë parasysh kushtet tekniko – higjenike dhe të mjedisit.

Neni 13

Obligimi i krijuesve të mbeturinavë komerciale

- 13.1 Krijuesit e mbeturinave komerciale, të regjistruar dhe të identifikuar nga Komuna, janë të obliguar ta informojnë Komunën – operatorin mbi sasinë e gjeneruar të mbeturinave dhe llojin e tyre.
- 13.2 Varësisht nga lloji i mbeturinave, krijuesi i mbeturinave komerciale obligohet në përmbushjen e kushteve të caktuara në bazë të marrveshjes me operatorin, si pajisjet me kontinjer adekuat per grumbullimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

Neni 14

Përzgjedhja e operatorit

- 14.1 Operatori ekonomikqë do të merret me grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave, zgjedhet me procedrë ligjore sipas LPP të Republikës së Kosovës;
- 14.2 Personat që menaxhojnë mbeturinat, licenca iu është lëshohet sipas dispozitave të neni 35 të Ligjit për Mbeturina.

Neni 15

Nderprerja e operimit për mbledhjen e mbeturinave

- 15.1 Nderprerja e aktiviteve të operimit për mbledhjen e mbeturinave bëhet vetëm atëherë kur operatori nuk iu përmbahet kushteve të përcaktuara me kontratë;
- 15.2 Para se të nderpritet kontrata, Komuna e njofton me shkrim operatorin lidhur me shkeljen e bere, jep vrejteje, propozon masa dhe cakton afatin kohor për zbatimin të kushteve të kontratës;
- 15.3 Me rastin e ndërprerjes së kontratës, operatorit i ndalohet aktiviteti për mbledhjen e mbeturinave.

Neni 16

Caktimi i tarifave dhe mënyra e pagesës /arkëtimit

- 16.1 Komuna i cakton tarifat për mbeturin, varësisht nga lloji i tyre, në bazë të rregullores për menaxhimin e mbeturinave;
- 16.2 Mënyra e arkëtimit të tarifave të cakruara në paragrafin 1 të këtij neni, do të rregullohet me vendim, të cilin do ta nxjerrë Kryetari i Komunes.

16.3 Tarifat/taksat e shërbimit

Llojet e shërbimit	Cmimi/njesia	Cmimi per kontinjer 120 litra	Cmimi per kontinjer 1100 litra
Ekonomite familjare/Amvisrite	4.50€		
Bizneset e vogla	10.00€		
Institucionet publike		1x5.00 € per zbrazje	1x13.00€ per zbrazje
Nredmarrjet e mdha dhe ndermarrjet me shërbime të veqanta (Bankat, Mishtoret, etj.) do të rregullohen me kontrata të vecanta.			

Neni 17

Raporti për menaxhimin e mbeturinave

- 17.1 Komuna duhet të paraqesë Ministrisë së Mjedisitë dhe Planifikimit Hapsinor raportin vjetor për realizimin e planit lokal për menaxhim të mbeturinave deri më 31 mars të vitit vijues;
- 17.2 Raporti përmban të dhëna për llojin, përmbajtjen, karakteristikat, sasinë, organizimin, ruajtjen, transportin, përpunimin, riciklimin, magazinimin dhe deponimin e mbeturinave si dhe të mbeturinave që pranohen në objektet dhe pajisjet për menaxhim të mbeturinave.

Neni 18

Mbikëqyrja inspektuese

- 18.1 mbikëqyrjen inspektuese për zbatim të kësaj rregulloreje e bënë inspektoriati i mjedisit i Drejtorise se Shërbimeve Publike;
- 18.2 Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, inspektoriati i mjedisit shqipton dënim mandator në shumën prej 5 € deri 100 €.
- 18.3 Dispozitat e Udhëzimit Administrativ të Ministrisë përbejnë shumën e gjobave të cilat i shqipton inspektoriati i mjedisit.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TE FUNDIT
Neni 19

Për zbatimin e kësaj rregulloreje janë kompetente Inspeksioni Mjedisor Komunal dhe Policia e Kosoves.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyne ne fuqi 15 dite pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL_së, dhe 7 dite pas publikimit në veb-faqen zyrtare te Komunës.

Më 28.03.2019
Mamushë

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Mamushës
Buyar Mazrek



DRAFT